



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

NR 54, DATË 04.09.2024

“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 113, DATË 14.12.2023 “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT AFATMESËM 2024-2026 DHE BUXHETIT VJETOR 2024”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 04.09.2024 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për një shtesë në vendimin nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09. datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, VKM-së nr 419, datë 26.06.2024 “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, VKM-së nr 425, datë 26.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar’ si dhe në mbështetje të VKB-së nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024” i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të miratojë shtesat në vendimin nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024” si më poshtë;
Shtohet
Programi AD115 Kap.01 Art 600 kod produkti V328AAA në shumën 2,583,465lekë.
Programi AD115 Kap.01 Art 601 kod produkti V328AAA në shumën 437,189lekë.
Programi AF115 Kap.01 Art 600 kod produkti V912AAA në shumën 9,254,162lekë.
Programi AF115 Kap.01 Art 601 kod produkti V912AAA në shumën 1,483,104lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo

KRYETARI I KËSHILLIT

